

Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin e Mesinës, Itali, për stafin akademik / ndihmës akademik me karakter administrativ/administrativ me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të programit Erasmus, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitetë përmesimdhënje në Universitetin e Mesinës në Itali, për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

<https://international.unime.it/>

Llojet e mobilitetit:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë përmesimdhënje / trajnim;
- Shkëmbimin e stafit ndihmës akademik me karakter administrativ / administrativ me kohë të plotë përmesimdhënje / trajnim;

Fushat e shkëmbimit (vetëm për stafin akademik):

- Biologji;

Për t'u njojur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Mesinës klikoni në linkun:

<https://international.unime.it/study-with-us/study-courses-in-italian/>

<https://international.unime.it/study-with-us/study-courses-in-english/>

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit / 12 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin për stafin (160 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)